

INTERESIM I DOBËT PËR KËSHILLIMOREN KUNDËR DUHANIT

NGA SHËNDETIT JAPIN DORËHEQJE, POR JO NGA CIGARET



Vetëm tetë shkupjanë kanë vendosur që ta vizitojnë këshillimoren, nga 300 punëtorët shëndetësor, të cilët ishin të njoftuar për këtë program, vetëm tre persona janë në fazën për dorëheqje nga duhani, por kur seriozisht ju është përkeqësuar gjendja. Në gishta numërohen shkupjanë të cilët kanë kërkuar ndihmë profesionale për tu dorëhequr nga pirja e duhanit në këshillimoren e Qendrës për shëndet publik Shkup, e cila është e hapur në qershor vitin e kaluar. Vetëm tetë vetë kanë vendosur që ta vizitojnë këtë këshillimore në këto gjashtë muaj, nga 300 punëtorët shëndetësor, të cilët ishin të njoftuar për këtë program, vetëm tre janë në fazën për dorëheqje nga duhani, por kur i është dëmtuar seriozisht shëndeti. Përveç në kryeqytet, kësi këshillimore për duhanpirësit janë edhe në 10 qendrat e shëndetit publik në tjera qytete, por edhe atje nuk ka lista të pritjes për heqjen e këtij vesi, të cilët vuajnë më shumë se një e treta e qytetarëve.

Nga 300 të informuar, vetëm 20 janë përgjigjur, Sipas udhëzimeve të Ministrisë së shëndetësisë, qendrat së pari i kanë hapur dyert për punëtorët shëndetësor- duhanpirësit, por as prej tyre, për fat të keq ende nuk ka interes të madh.

Personalisht nga stafi i repartit të mjekësisë sociale pran Qendrës për shëndet publik – Shkup janë informuar mjekët dhe teknikët mjekësor të cilët vijnë në hapësirat tona, edhe atë për punën e këshillimores, për mundësit për përdorimin e shërbimeve të saja dhe për mënyrën e punës. Bëhet fjalë për 295 persona shëndetësor të informuar. Informimi është më qëllim të dyfishtë – për të punësuarit shëndetësor të njëjtat informacione mund edhe më tej ti informojnë edhe kolegët në institucionin e tyre, por edhe pacientët që vijnë në kontakt të përditshëm. Edhe pse ishin të informuar përafërsisht 300 person, edukimet shëndetësore në formë të ligjëratave interaktive apo punëtori, nga qershori deri sot, për fat të keq, janë përfshirë

vetëm 20 punëtorë shëndetësor. Por asnjëri prej tyre nga institucionet e tjera shëndetësore nuk treguan interes për vazhdimin e procedurës për heqjen dorë nga pirja e duhanit, vetëm tre kolegë nga qendra jonë u bashkua me trajtime individuale dhe ka rezultat, dy më nuk pinë duhan qe dy muaj, dhe i treti është në fazën e dorëheqjes- thotë d-r Vesna Spirova, specialist për mjekësisë sociale në Qendrën.

Tre të punësuar japin dorëheqje

Ajo shpjegon se si funksionon këshillimorja. Kemi tretmanë individual të cilët tre të punësuarit tanë dy burra dhe një grua. Një është punëtorë social, dhe dy janë statistikor shëndetësor. I pari ka dëshirë të madhe dhe mendon se tash është koha për të dhënë dorëheqje nga pirja e duhanit. Ai ka 30 vjet eksperiencë si duhanpirës, dhe është në moshën 52 vjeç dhe koha ishte për ta lënë duhanin, ka problem me rrugët e frymëmarrjes. Gruaja është në moshën e njëjtë, 52 vjeçare, dhe pinë duhan dhjet vite, dhe tani më ka probleme shëndetësore me frymëmarrjen, i ndalet fryma, dhe kanë vërtetuar se gjendet në bazën e alergjisë. Ajo është e vetëdijshme se duhet ti ndërpret cigaret edhe e kemi lënë në tretman individual dhe ende është në fazën e dorëheqjes. E dimë se ajo nuk është aq e lehtë. Dhe dy kolegët kanë dhënë dorëheqje dhe nuk pinë duhan- njëri më qe tre muaj. I ndjekim në gjithë periudhën dhe ata rregullisht vijnë në tretman, kanë dosje dhe shënojmë deri ku është dorëheqja. Fitojnë broshure të shohin se çfarë të marrin për të qenë më lehtë dorëheqja. Ato sigurisht nuk pinë më thotë Spirova.

Në pyetjen se cili është interesi i përgjithshëm i popullatës për përdorimin e shërbimeve të këshillimores, ajo me përgjigje: pas shpalljes nga ministria për këshillimoren për dorëheqje nga duhani është në dispozicion për popullatën, kemi pasur tetë thirrje nga palët e interesuar për ta vizituar trajnimin. Me ata janë bërë kontakte, janë hapur dosje personale, por nuk mund të themi se motivi i tyre është shumë i fortë dhe kemi shkuar aq larg në procesin nga dorëheqja e duhanit. E shfrytëzojmë edhe mundësin ku tek ne vijnë të punësuar në trajnim për sigurinë e ushqimit para trajnimit i informojmë se ekziston këshillimore për dorëheqje nga duhani, por i bëjmë edhe anketa që të shohim se si është shpërndarja e duhanpirësve, në cilën moshë dhe nga cila gjini janë – thotë Spirova.

Serioz kur të shfaqen problemet

Mjekët thonë se askush nga duhanpirësit nuk mendojnë seriozisht për shëndetin deri sa nuk ballafaqohen me probleme. Perceptimi ynë i përgjithshëm mbetet në atë që është në literaturë: Së pari askush nuk mendon seriozisht për shëndetin deri sa nuk ballafaqohet me problemet e para që i bart sëmundja. Së dyti, që informacioni dhe ngritjen e nivelit të dijes kryesisht dhe drejtpërdrejt ndikojnë në qëndrimet tona, por për të bërë një ndryshim në sjelljen aktuale, duhet diçka më shumë, si dëshirë të fortë, motiv të fortë, shembull i mirë dhe të ngjashme. Përvojë e shkurtër me punën e këshillimores nga fundi i qershorit e deri me sot na tregoj se të

interesuarit këtë pyetje e marrin parasysh si personale dhe më shumë duan që kontakti me të punësuarit të jetë një lloj i angazhimit individual- thotë Spirova.

Autorë: Lubica Ballaban

E marrë nga Denvnik Online

Data 14.01.2015